



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

REKTORI

Nr. 2694/prot.
/1

Tiranë, më 07/10 /2019

URDHËR

Nr. 99, datë 07.10.2019

PËR

**FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE CAKTIMIN E DATËS SË ZHVILLIMIT
TË ZGJEDHJEVE PËR KOMISIONIN E PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS
SHKENCORE "DOKTOR" NË NIVEL NJËSIE KRYESORE NË UNIVERSITETIN E
MJEKËSISË, TIRANË**

Në bazë të nenit 39, 46 e vijues ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 28, 29, 32, 35 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së nxjerrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Senatit Akademik nr. 57, datë 27.09.2019 "Për nisjen e procedurave për krijimin e Komisionit të Përhershëm për dhënie e gradës shkencore "Doktor" në nivel njësie kryesore në UMT",

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për Komisionin e Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor" në nivel njësie kryesore në UMT, në datë 08.10.2019.
2. Votimi për Komisionin e Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor" në nivel njësie kryesore në UMT, do të zhvillohet më 11.11.2019.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) dhe njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

REKTORI

ARBEN GJATA

